

THIRRJE PËR PJESËNËMARRJE - "E DUA RAJONIN TIM"

KONKURSI FOTOGRAFI DHE VIDEO PROMOVUES PËR RAJONET EKONOMIKE TË KOSOVËS

15 Shkurt – 15 Mars, 2024

Të dashur krijues të fotografisë dhe videos, ne ju ftojmë që të merrni pjesë në një udhëtim vizual të iniciuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, UN-Habitat Kosovë, dhe Qeveria e Suedisë, tek sa ju prezentojmë Konkursin e parë të Fotografisë dhe Videos të titulluar “E Dua Rajonin Tim”. Ky konkurs synon të theksoj asetet dhe potencialet e ndryshme – njerëzore, ekonomike, dhe natyrore – të paraqitura në entitetin e rajoneve ekonomike të Kosovës. Jeni të inkurajuar që të kapni këto momente të gëzueshme, dhe përmes të shprehurit tuaj vizual të theksoni çdo mundësi, çdo fokus që duhet të ndahet, çdo situatë optimiste që definon shpirtin pozitiv dhe vibrant të shtatë rajoneve të Kosovës.

Detajet e tjera sa i përket kritereve të aplikimit mund ti gjeni në linqet në vijim: [xxx](#)

Ministria e Zhvillimit Rajonal, UN-Habitat Kosovë, dhe Qeveria e Suedisë.